



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Korçë, më datë 18/10/2018

Proces-verbal nr. 1

Bazuar në LIGJIN Nr 139/ 2015, neni 3, pika “dh”, në datën 17 tetor 2018 në kuadrin e procesit të “Buxhetimit me Pjesëmarrje”, për të diskutuar lidhur me kërkesa dhe shqetësime të banorëve, u zhvillua takimi me banorët e qytetit të Bashkisë Korçë.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin z. Sotiraq Filo Kryetar Bashkia Korçë, z. Kletjon Kita Zv.Kryetar Bashkia Korçë, Ilir Dinellari Drejtor I NSHP, Leonard Gjançi Dr. I Menaxhimit të Kontratave.

Fjalën e mori i pari z. Sotiraq Filo, i cili listoi disa nga investimet e mëdha të realizuara por edhe në proces në qytetin e Korçës dhe Njësitë Administrative. Mes tyre përmendi projektet : Ndërtimi I km të parë të rrugës Korçë- Erskeë, Rikonstruksioni i Voskopojës, “Rikonstruksioni i Pazarit të Vjetër të Korçës, Ndërtimi I “Kompleksit Multifunksional Sportiv dhe Kulturor”, Markata e re e Korces, Parku Japonez, nderhyrje me lagjet 13,5 te qytetit etj. Në vazhdim ai foli edhe për rëndësinë e marrjes së mendimeve të qytetarëve dhe vendosjen e prioriteteve për investimet pasi impakti i parë i çdo projekti perceptohet prej tyre.

Pasi u njohën me shpjegimet përkatëse për “Buxhetimin me pjesëmarrje”, qytetarët e Korçës patën hapësirën e nevojshme kohore për të ngritur kërkesat e tyre dhe për të vendosur prioritetet sa i takon fokusit të investimeve të Bashkisë Korçë për vitin 2019. Kërkesat e tyre u mbajtën shënim paralelisht dhe të detajuara. Bazuar në kërkesat e ngritura nga qytetarët u listuan prioritetet si më poshtë:

1. Zëvendësimi i kiteve shkollore në kopshtin nr 9
2. Ndërtimi i një çerdhe të re
3. Rikonstruksioni i këndit sportiv në lagjen 9

4. Rikonstruksioni i fasadave të pallateve lgj 10
5. Zëvendësimi i kapakëve të pusetave në rastet kur janë vjedhur apo dëmtuar
6. Permiresimi i lulishtes ne lagjen 15 te qytetit

Përvëç ndërhyrjeve në infrastrukturë të sipërcituara ku banorë të së njëjtës lagje mbështesnin kërkesat e njëri-tjetrit , u sollën edhe sugjerime për projekte në aspektin social.

(XXX): Bashkia duhet të gjejë një hapësirë dhe t'i angazhojë edhe gratë pensioniste me aktivitete të tjera kryesisht artizanati duke e bërë më të kompletuar dhe funksional këtë projekt. Nderkaq ka edhe me teper nevoje per angazhimin dhe perfshirjen e te rinjve.

(XXX): Është e domosdoshme që të ndërtohet një çerdhe e re për fëmijët në qytet pasi ekziston vetëm një çerdhe dhe është e pamundur të përballojë fluksin e fëmijëve. Gjithashtu në disa nga kopshtet kitet shkollore janë të pakta dhe të pamjaftueshme.

(XXX): Përgjatë rrugës së dritave të verdha në lagjen 10 të qytetit vazhdojnë të bien suvatë e pallateve si pasojë e amortizimit. Është një problem i vazhdueshëm dhe me rrezikshmëri të lartë për banorët.

(XXX): Në lagjen 10 janë vjedhur kapakët e pusetave. A mund të merren masa për zëvendësimin e tyre në mënyrë që të mos qëndrojnë të hapura dhe të mos dëmtohen qytetarët që lëvizin në këtë rrugë?

(XXX): Nuk jane bere investime ne zonen e SMT. E dime qe ka problematikat e veta sa i takon informalitetit por ka nevoje per ndricim, rruge, kanalizime sepse edhe ne jemi banore te ketij qyteti.

**Drejtores e Marredhenieje me Publikun
dhe Informimin Qytetar:**

Larisa Katundi